



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nh. 1885 Prot
27/12/2022

Nr. 788 Prot.

Tiranë, më 20.12.2022

URDHËR

Nr. 16, Datë 23.12.2022

Për zgjedhjen e Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” në Muzikologji

Mbështetur Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 *Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, Neni. 42, 79; VKM Nr. 112, datë 23.02.2018, *Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të Standarteve Shtetërore për fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”*, Kreu I, i ndryshuar; Urdhërin e MAS Nr. 128, datë 16.03.2022 *Për hapjen e programit të studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në “Muzikologji”, në Universitetin e Arteve të Tiranës*, Statutin e Universitetit të Arteve Tiranë, Kreu III, Neni 22,32, Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji në Njësinë Bazë KMDP në Fakultetin e Muzikës, Kreu. II, Neni. 5, miratuar me VSA Nr. 34, datë 17.11.2021, sikurse dhe me propozim të Përgjegjës të Njësisë Bazë KMDP urdhëroj:

1. Procesi zgjedhor për anëtarët e Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji fillon datë 09.01.2023.
2. Komisioni i sipërpërmendur, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji në Njësinë Bazë KMDP në Fakultetin e Muzikës, sikurse dhe në VKM Nr. 112, datë 23.02.2018, *Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të Standarteve Shtetërore për fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”*, Kreu I, i ndryshuar, do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të kategorisë Profesor, të cilët do të zgjidhen mes stafit akademik të Fakultetit të Muzikës.
3. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji vetëkandidohen. Mandati i anëtarëve të komisionit të sipërpërmendur është dyvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin kërkesë me shkrim pranë Njësisë Bazë KMDP deri në datën 13.01.2023

4. Datë 14 Janar 2023, Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Muzikës, shpall, në ambientet e Fakultetit, si dhe web listën e kandidatëve për anëtarë në Komisionin e Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji.
5. Përsa përket procedurave të përcaktimit të anëtarëve të komisionit zgjedhor për Komisionin e Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji. nisur nga procedura e përzgjedhjes së komisioneve zgjedhore, sipas rregullores së zgjedhjes së autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Arteve Tiranë, miratuar me VSA Nr. 19, datë 10.02.2020, vlerësoj se komisioni zgjedhjeve do të ketë në përbërje të tij anëtarët e KZF së fundit. Rolin e sekretarit të komisionit zgjedhor do ta kryej znj. Drita Dederaj.
6. Zgjedhjet do të zhvillohen datë 17 Janar 2023.
7. Sekretaria mësimore i dorëzon komisionit zgjedhor listën e anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë pranë FM.
8. Në përfundim të procesit zgjedhor, komisioni dërgon në dekianat një procesverbal për zhvillimin dhe procedurat e ndjekura, sikurse dhe për pjesëmarrjen e votuesve dhe numrin e votave për çdo kandidat. Komisioni zgjedhor, merr vendimin përfundimtar për shpalljen e kandidatëve fitues.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Përgjegjësi i Njësisë Bazë KMDP, Sekretaria mësimore në FM dhe anëtarët e personelit akademik pranë FM.
10. Përsa i përket procedurave të tjera, ankimore etj, zbatohen parashikimet e rregullores *Për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet Drejtuese dhe Senatin Akademikë në Universitetin e Arteve Tiranë*, miratuar me VSA Nr. 19, datë 10.02.2020.
11. Ky urdhër shpallet në ambientet e Fakultetit të Muzikës. Një kopje dërgohet pranë Rektoratit të UART.

Prof. Dr. Isak Shehu
Dekan Fakulteti i Muzikës
Universiteti i Arteve

